



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

PSH. nr. 264/22

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetarja në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Vedat Poterqoi- Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtare si dhe Nita Bejta- Anëtare, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK- KK Gjakovë me numër 264/22, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE "Marisa & Gërlica Company" sh.p.k-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i Parkut të Qytetit-Kontratë tre vjeçare", me nr. të prokurimit: 632-18-052- 5-2-1, iniciuar nga KK Gjakovë, më: 17 tetor 2022, mori këtë:

#### V E N D I M

- I. **REFUZOHET**, si e pa bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues- KK Gjakovë, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE "Marisa & Gërlica Company" sh.p.k-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i Parkut të Qytetit-Kontratë tre vjeçare", me nr. të prokurimit: 632-18-052- 5-2-1, iniciuar nga KK Gjakovë. AK mund të udhëzohet për më tej në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD).

#### A R S Y E T I M

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me datën 23.05.2022, Autoriteti Kontraktues- AK- "KK-Gjakovë" ka dorëzuar në OSHP kërkesën për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP-së ndaj OE "Marisa & Gërlica Company" sh.p.k-Gjakovë. Me dt 01. 06. 2022, ekspertja shqyrtuese ka pranuar autorizimin lidhur me përgatitjen e një kronologjie lidhur me kërkesën AK- KK Gjakovë ku ka sqaruar:

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

AK- “KK-Gjakovë” me datë 15.04.2022 ka lidhur kontratën me operatorët ekonomik “Marisa & Gërlica Company” sh.p.k-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi i Parkut të Qytetit-Kontratë tre vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-18-052- 5-2-1.

Me datën 13.05.2022 është bërë ndërprerja e kontratës nga ana e Autoritetit Kontraktues, pasi që operatorët ekonomik “Marisa & Gërlica Company” sh.p.k- Gjakovë nuk kanë bërë realizimin e punimeve konform kushteve të kontratës. Gjithashtu nuk u janë përgjigjur urdhëresave për vazhdimin e punëve e as e-mail të menaxherit të kontratës.

AK ka bashkëngjitur dokumentet si në vijim:

-Kopja e komunikimeve të menaxherit të kontratës

-Kopja e shkresës së KK Gjakovë drejtuar OE për shkëputjen e kontratës.

OSHP pas pranimit të kërkesës AK- “KK-Gjakovë” i ka dërguar email operatorit ekonomik me datën 30.05.2022 duke i kërkuar që të jap sqarime në lidhje me këtë çështje.

OE Marisa & Gërlica Company” sh.p.k-Gjakovë me datën 01.06.2022 ka dërguar një email me të cilin kanë informuar se janë në përgatitje të një raporti me të cilin do ti ofrojnë sqarimet lidhur me këtë kërkesë të AK-së për diskualifikimin e tyre.

Eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 99.2 të LPP-së, marrja e masave nga OSHP-ja, ndaj operatorëve ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit vjen në shprehje vetëm nëse konstatohet se operatori ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit ka prezantuar dokumente të falsifikuar, apo ka bërë paraqitjen e të dhënave të rreme ashtu siç parashihet me nenin 99.2. të LPP-së, në të cilin thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Konsiderojmë se kërkesa për diskualifikim nuk është paraqitur për asnjërin nga kriteret e parapara me dispozitat e aplikueshme si më lart, andaj do të ishte e arsyeshme që AK të udhëzohet në procedurë gjyqësore.

OSHP seancën dëgjimore e ka mbajtur pa prezencën e palëve pasiqë nga shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për marrjen e një vendimi përfundimtar.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës dëgjimore konstaton se autoriteti kontraktues – KK Gjakovë, nuk ka dorëzuar asnjë provë që dëshmon se OE “Marisa & Gërlica Company” sh.p.k-Gjakovë në këtë aktivitet të

prokurimit, ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi, për të cilën edhe OSHP, mund të merr masa konkrete ndaj ndonjë operatori ekonomik.

Paneli shqyrtues është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka arritur të ofroj ndonjë dëshmi apo prove për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e OE “Marisa & Gërlica Company” sh.p.k-Gjakovë për aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i Parkut të Qytetit-Kontratë tre vjeçare”, me nr. të prokurimit: 632-18-052- 5-2-1.

Paneli shqyrtues sqaron se konform nenit 99 par 2 të LPP-së kompetencat e OSHP-së për ta futur një operator në listën e zezë janë për shkak të falsifikimit të dokumentit apo paraqitje të dokumentacionit të rremë, ndërkaq sa i përket mos ekzekutimit të kontratës AK duke u bazuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) mund të drejtohet në gjykatën kompetente për realizimin e të drejtave të përcaktuara më ligj.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryetar i Panelit Shqyrtues  
  
Vedat Poterqoi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Gjakovë

1x1 OE ankues

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.